



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 01, Datë 22.01.2024

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2023 PËR  
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2/1 prot., datë 16.01.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Dhjetor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr. 9130 prot., datë 29.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 02 prot., datë 03.01.2024, shoqëria FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE aplikimin mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit Dhjetor 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Mbështetur në nenin 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Dhjetor 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, i cili la në fuqi vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Dhjetor 2023, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin dhjetor 2023</i>		
	<b>Njësia</b>	<b>Çmimi</b>
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	12.17
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.37
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
<b>Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA</b>	<b>Leke/kWh</b>	<b>16.00</b>

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *16.00 Lekë/kWh për muajin Dhjetor 2023*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Dhjetor 2023, prej 16.00 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**